



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 1169/9 Prot.

Koplik, më 02.06.2025

V E N D I M

NR, 13 DATË 30 / 05 / 2025

PËR

1. "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Aleksander Gjovalin Makaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Aleksander Gjovalin Makaj nga programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr 81 datë 31.12.2024 "për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afat mesem 2025-2027 të Bashkisë Malësi e Madhe".

Baza Ligjore

Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Vendosi;

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit z. Aleksander Gjovalin Makaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
2. Burimi i financimit të jetë fondi i Emergjencave Civile parashikuar në Programin "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile", në buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2025 të miratuar me VKB. .81..date 31..12.2024 në programin "Perballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet në raste fatkeqesie".
3. T'i akordojë familjes së shtetasit Z. Aleksander Gjovalin Makaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vlerën/shumen 100.000 (njqind mijë) lekë , në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr.81, datë, 31.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Malësi e Madhe ", nga fondi i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe, nga Programi "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 03280".

4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjorë të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për familjen e z **Aleksander Gjovalin Makaj**, në vlerën e dëmit nga ana ndertimore në shumen **1.888.713**(njëmilion e teteqind teshjete e tete mije e shtateqind e trembedhjete) lekë, 50% i saj është **944.356**(Nenteqind e katerdhjete e kater mije e treqind e pesedhjete e gjashte) leke dhe elektroshtëpijake në shumen **280.900**(dyqind e tetedhjete mije e nenteqind) lekë,ku 50% i saj është **140.450** (njëqind e katerdhjete mije e katerqind e pesedhjete) leke .sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Malësi e Madhe.Vlera totale e dëmeve është **2.169.613** Dymilion e njëqind e gjashtedhjete e nente mije e gjashteqind e trembedhjete) leke ku 50% i saj është **1.084.806** (Njemilion e tetedhjete e kater mije e tetqind e gjashte)leke
5. Ngarkohet administrata e bashkisë Malësi e Madhe për likuidimin e shumes prej **100.000** (njqindë mijë) lekë.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Finances dhe sektori i Emergjencave Civile.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 30.05.2025

Vota Pro 20

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me date 02.06.2025

